



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
20.02.2023

Me datë 20.02.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Teuta Zaja, Aurora Dibra, Diana Muriqi, Tereze Brigja, Ardiana Ndreu, Jona Leqeja, Vjollca Petani, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Kristi Agnes Shllaku, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Luan Heta, Oltion Luli, Julian Kraja, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Avenir Celaj, Marjan Ndërshtiqaj, Sead Cocja, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj, Besmir Vukaj, Arbis Vjerdha, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Luigi Palushi, Nadir Spahija, Lindita Nika.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *"Për miratimin e listës shitesë të përfutuesve pranë banesave sociale me qira të administruara nga Bashkia Shkodër"*
2. Pr/ Vendim *"Për disa ndryshime në VKB nr.1 datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër për vitin 2023"*
3. Pr/ Vendim *"Për miratimin e planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër"*
4. Pr/ Vendim *"Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastrë 104, nj.a Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë "Ëind Stream sh.p.k"*
5. Pr/ Vendim *"Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastrë 104, nj.a Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Voltalia Albanie"*
6. Pr/ Vendim *"Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të tretëve të objektit "Kinema Milenium", ndodhur në zonën kadastrale 8593, pasuria me nr.4/732, 4/731 me adresë Blv.Skënderbeu", në pronësi të Bashkisë Shkodër, për një afat 5 vjeçar, me kontratë qiraje nëpërmjet procedurave konkurruese"*

7. Pr/ Vendim "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër"
8. Pr/ Vendim "Për emërtimin e shkollës 9 vjeçare Dragoç në Njësinë Administrative Postribë me emrin "Ismet Celaj"
9. Pr/ Vendim "Për miratimin e emërimit të sheshit përpara stadiumit Loro Boriçi me emrin "Ramazan Rragami"
10. Pr/ Vendim "Për miratimin e ndryshimit të një segmenti të rrugës "Dasho Shkreli" në rruga "Zamir Shpuza"
11. Pr/ Vendim "Për kalimin e mjetit ambulancë tek njësia vendore e kujdesit shëndetësor Shkodër, për qendrën shëndetësore Dajç"
12. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur nga kryetarja e Këshillit, e cila prezanton rendin e ditës së bashku me tre propozime për shtesë.

1. Pr/ Vendim "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2023"
2. Pr/ Vendim "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Shkodër për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga termeti në Turqi"
3. Pr/ Vendim "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2023, e miratuar me Vkb nr.71, date 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër"

Përpara se rendi i ditës të hidhet në votim, fjalën e merr Znj. Mandija, e cila në emër të grupit të këshillëtarëve socialist propozon heqjen dhe shtyerjen për një moment të dytë pikës 2., pasi akoma nuk është e qartë nëse kjo është rritja e duhur apo jo e tarifave në këtë pikë të vitit shkollor. Shihet, pra si e papërshtatshme në këtë moment rritja e pagesës së kopshteve e çerdheve. Gjithashtu ajo shton se duke parë rëndësinë e pikave të propozuara shtesë, mendojnë të merren në shqyrtim të parat. Po ashtu edhe pika e fundit e rendit të ditës, të kalohet në fillim

Edhe Z. Vukaj shprehet se në lidhje me pikat 4,5,6 të rendit të ditës duhet të merret paraprakisht një mendim nga KQZ, nëse kanë përputhshmëri me nenin 91 të Kodit Zgjedhor meqënëse jemi në prag zgjedhjesh. Ai mendon të shtyhet deri sat ë merret një përgjigje.

Fjalën e merr Znj. Brigja, e cila kërkon që mbledhja e Këshillit bashkiak të shtyhet për të hënë e ardhshme, pasi mendon që prania e kryetarit të Bashkisë është e rëndësishme.

Edhe Z. Vjerdha shprehet se në lidhje me pikat 8,9,10 të rendit të ditës është shumë dakort për çdo titull dhe repekt që mund t'i jepet figurave në fjalë por mendon që nuk duhet të punohet me dy standarte, pasi ai ka bërë propozime për figura shumë të shquara të qytetit të Shkodrës

dhe nuk janë marr parasysh. Prandaj ai propozon heqjen e tyre dhe të sillen njëherazi të gjitha kërkesat për personalitete që kanë dhënë shumë për Shkodrën.

Znj.Kadija propozon heqjen e dy pikave në lidhje me emërtesat e rrugëve dhe të lihen për një moment tjetër.

Fjalën e merr Z.Dedaj, i cili sqaron në lidhje me pikën 2., pasi mendon se tregu tashmë është i testuar nga INSTAT. Ky projekt vendim nuk është vetëm për këtë vit shkollor apo buxhetor por për në vazhdimësi, prandaj nuk e sheh të arsyeshme heqjen nga rendi I ditës. Kurse në lidhje me pikën 4,5 bëhet fjalë për një sipërfaqe të vogël dhe dhënia e saj me qira nuk është me konkurim dhe nuk ka ndonjë problem, megjithatë vendimmarrja ju takon ju.

Znj.Mandija thekson se grupi i këshilltarëve socialistë vazhdon t'i qëndrojë propozimit fillestar.

Edhe Z.Vukaj shprehet se ai nuk kërkoi heqjen e këtyre pikave, por thjesht shyerjen deri në një konfirmim për përputhshmërinë e tyre me Kodin Zgjedhor.

Rendi i ditës hidhet në votim së bashku me ndryshimet e propozuara, ku rezultojnë __ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/ Vendimin *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2023”*

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit për çështjet sociale, dhe grupit të këshilltarëve socialistë Znj.Mandija shprehet pro këtij Pr/vendimi. Po ashtu edhe Z.Sokoli, në emër të grupit PSD shpreh dakordësi. Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 32 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

2.Vijohet me pikën 2. të propozuar, Pr/ Vendim *“Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Shkodër për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga termeti në Turqi”*

Përsëri fjalën e merr Z.Dedaj i cili shprehet shkurtimisht mbi nevojën e solidaritetit me shtetin Turk në këto momente të vështira.

Z.Vjerdha mendon se shteti Turk nuk ka nevojë për mbështetje financiare por për ndihmë njerëzore që të ndihmojnë si krah pune.

Z.Galiqi merr fjalën dhe shpreh solidaritetin e tij por mendon se destinacioni i kësaj shume modeste duhet të saktësohet.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve: Znj.Mandija shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 1 Kundër, 2 Abstenim.

Miratohet

3. Kalohet në pikën tjetër shtesë; Pr/ Vendim *“Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2023, e miratuar me Vkb nr.71,date 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”*

Përsëri Z.Dedaj relatton dhe sqaron edhe njëherë rëndësinë e ndërtimit të urës në fshatin Rragam në Nj.administrative Gur i Zi.

Kalohet përsëri tek mendimi i kryetarëve të grupeve: Znj.Mandija shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

4. Kalohet në pikën tjetër Pr/ Vendim *“Për kalimin e njetit ambulancë tek njësia vendore e kujdesit shëndetësor Shkodër,për qendrën shëndetësore Dajç”*

Z.Dedaj merr fjalën dhe relation përsëri sipas relacionit të përgatitur nga administrata.

Merret përsëri mendimi i kryetarëve të grupeve: Znj.Mandija shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

5. Kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim *“Për miratimin e listës shitesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira të administruara nga Bashkia Shkodër”*

Relaton Z.Dedaj shkurtimisht mbi materialin e paraqitur.

Në emër të grupit socialist Znj.Mandija shprehet pro miratimit dhe vlerëson punën e kryer, po ashtu edhe Z.Sokoli shpreh dakordësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6. Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim *“Për miratimin e planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër”*

Relaton në mënyrë të detajuar sipas materialit të përgatitur Znj.Shllaku, drejtoreshë në drejtorinë e Mbrojtjes së mjedisit në Bashkinë Shkodër.

Z.Vjerdha kërkon të dijë masat që ka marrë Bashkia Shkodër për parandalimin dhe sensibilizimin kundër prerjes së pyjeve.

Përgjigjet Znj.Shllaku dhe sqaron se Bashkia Shkodër ka një sektor të veçantë që merret me pyjet i përbërë nga 14 specialistë (teknikë pyjesh) dhe drejtori që është inxhinier pyjesh dhe ato nuk kanë për detyrë ruajtjen e pyjeve, sepse ruajtja e tyre bëhet nga inspektoriati i pyjeve, i cilimkrijohet me ligj dhe akoma nuk kanë dal aktet nënligjore mbi mënyrën e funksionimit të tyre. Deri më tani funksionojnë me drejtori rajonale me qëndër në Tiranë.

Kurse masat që merr Bashkia janë; që çdo vit angazhon 10 rojtarë pyjesh , të cilët janë vrojtues të paguar në bazë të Kodit të punës dhe fillojnë punën Maj-Tetor sipas VKM përkatëse.Cdo gjë është e specifikuar në kontratat e tyre të punës.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

7. Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim *“Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë,Bashkia Shkodër”*

Për këtë projekt vendim relaton Z.Koçkiçi sipas relacionit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Fjalën e merr Z.Nika e cila shprehet se pas një korrespondence të gjatë me drejtorinë e planifikimit në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, mendon se Bashkia Shkodër ka qëne mjaft bashkëpunuese duke arritur në një pikë të përbashkët. Ajo mendon se “problem” mbetet menaxhimi i situatës në sezonin veror nga strukturat përkatëse në respektimin e zonave të plazheve publike dhe atyre private.

Z.Galiqi aprovon faktin që ky pr/vendim këtë vit vjen në kohë për sezonin që po afrohet. Ai kërkon të dijë se çfarë masash do merren për rojet bregdetare dhe të ardhurat e përfituara a shkojnë në buxhetin e bashkisë apo të qeverisë qëndrore.

Përgjigjet Z.Koçkiçi, i cili sqaron se pjesa e rojeve bregdetare është e rregulluar nga legjislacioni në fuqi me specifikime të sakta. Kurse përfitimi ekonomik nga taksat e stacioneve të plazhit është i Bashkisë Shkodër.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

8. Kalohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim “Për emërtimin e shkollës 9 vjeçare Dragoç në Njësinë Administrative Postribë me emrin “Ismet Celaj”

Fjalën e merr Z.Avenir Celaj, i cili shprehet se ndihet i nderuar për të folur për të ndjerin Ismet Celaj dhe fton këshillëtarët ta miratojnë këtë pr/vendi në nder të tij.

Kalohet përsëri në mendimin e kryetarëve të grupeve, Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr përsëri Z.Vjerdha, i cili ka konstatuar që zëri i këshillëtarëve nuk dëgjohet dhe kjo sipas tij lë vend për dyshime.

Z.Kadija sqaron që kjo nuk është e vërtetë dhe ka vend për dyshime sepse mbledhjet transmetohen live për të vërtetuar transparencën.

Znj.Tyli merr fjalën dhe shpreh përsëri shqetësimin e saj në lidhje me mbeturinat. Ajo shprehet se Shkodra vazhdon të mbetet qyteti më i ndotur. Po ashtu edhe për zaptimin e hapësirave publike nuk është marr asnjë masë akoma.

Z.Dedaj përgjigjet dhe thotë se nuk pranon që Shkodra është qyteti më i ndotur sepse pastrimi kryhet por problemi mund të mbetet tek qytetarët e padisiplinuar. Kurse në lidhje me hapësirat publike mbetet një sfidë e vazhdueshme sepse kemi mundësi të kufizuara.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Kadija e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 20.02.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 6 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

KRYETARE

